



Instituti i Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë

Lagja e Spitalit nr.3, Prishtinë, Kosovë 10000

Tel. +381(0) 38 512-392

institutihi@hotmail.com

<http://ëëë.ihp-ks.org>

**KOLEGJI AAB
AAB COLLEGE**

Prishtinë

Nr. 2112 data: 24.10.2016

PRISHTINË

Kolegji AAB

Kolegji AAB Zona Industriale Prishtinë - Fushë Kosovë

Tel: +381 (0) 38 600 005

Mob: +377 (0) 45 284 797, +386 (0) 49 603 666

info@aab-edu.net

<http://aab-edu.net>

Duke marrë parasysh interesin e dyanshëm për zhvillimin dhe bashkëpunimin institucional në sferën e procesit edukativ-arsimor dhe të hulumtimeve kërkimore - shkencore me interes të veçantë kombëtar, e në mbështetje të statuteve të tyre Instituti i Historisë Prishtinë, të cilin e përfaqëson Prof.assoc.dr. Sabit Sylja (në tekstin e mëtejshëm: Drejtori), në njërin anë, dhe Kolegjin AAB në Prishtinë, të cilin e përfaqëson Prof. assoc.dr. Lulzim Tafa (në tekstin e mëtejshëm: Rektori), në anë tjetër, lidhin këtë

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Palët pajtohen për bashkëpunim të ndërsjellë

1. Sipas mundësive, e në pajtim me këtë Marrëveshje, do të shkëmbejnë informata të përbashkëta për botimin e dokumenteve, punimeve të veçanta dhe botimeve të tjera në sferën e interesit të veprimtarisë së tyre me karakter edukativ arsimor, si dhe në sferën e hulumtimeve kërkimore - shkencore.
2. Subjektet e kësaj Marrëveshjeje do të hartojnë programe të posaçme pune të miratuara nga organet qeverisëse të institucioneve të tyre.
3. Obligohen që të ofrojnë informata dhe bashkëpunim, si dhe dokumente me interes për procesin mësimor-shkencor dhe kërkimor-shkencor për historinë e Kosovës dhe me gjerë.
4. Obligohen që punëtorëve të tyre shkencorë, me kushte të posaçme reciproke, t'iu mundësojnë shkëmbimin dhe shfrytëzimin i lendeve arkivore dhe literaturës për nevojat shkencore.
5. Pajtohen që të bëjnë angazhimin e ekspertëve të njëra - tjetrës për periudha dhe fusha të caktuara si në procesin e mësimdhënies e të përgatitjeve të magjistratëve dhe doktorantëve të rinj, ashtu edhe në procesin kërkimor-shkencor (simpoziume, konferenca shkencore etj), duke u mbështetur në kontrata të veçanta
6. I bëjnë të ditur njëra tjetrës mbajtjen e fondeve arkivore, koleksioneve librare dhe i rekomandojnë njëra-tjetrës hulumtimin dhe studimin për projekte të caktuara me ters për dy palët.

7. Do të shkëmbejnë kuadro hulumtuesish të rinj në lëmin kërkimore-shkencore me qëllim të përgatitjes së tyre për mision profesional të realizimit të projekteve dhe programeve me interes të institucioneve përkatëse.
8. Punëtorët hulumtues dhe shkencor të dy palëve që hulumtojnë në ekipe të përbashkëta obligohen që gjatë hulumtimeve të tyre nga një kopje të dokumentacionit t'ia dorëzojnë shërbimit përkatës të secilit institucion, me qëllim të pasurimit të fondeve arkivore.
9. Nënshkruesit pajtohen që të shkëmbejnë dokumentacionin arkivor, përkatësisht fondet arkivore që u janë të nevojshme në mënyrë reciproke (fotokopje, mikrofilma, riprodhime në bartës elektronikë-CD), si dhe botime të tjera shkencore mbi bazën e barazisë.
10. Do të botohen punimet shkencore të studiuesve të njërës dhe palës tjetër në revistat "Kosova" dhe "Thesis Kosova".
11. Pajtohen të bëjnë punë të përbashkët për botimin e dokumenteve, botimeve kërkimore-shkencore etj, duke u mbështetur në kontrata të veçanta.
12. Përfaqësuesit e të dy palëve do të takohen së paku dy herë në vit për të ndjekur ecurinë e realizimit të veprimtarisë së kësaj Marrëveshjeje.
13. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet ose të plotësohet me miratimin e të dy palëve.
14. Marrëveshja është e vlefshme për periudhën 2 vjeçare nga data e nënshkrimit.
15. Marrëveshja është hartuar në gjuhën shqipe në katër kopje identike, nga dy kopje për secilën palë.
16. Marrëveshja hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dy palët.

PALËT NËNSHKRUESE



Prishtinë 24 . 10 . 2016

